

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura Shtetërore 2020

Lënda: Gjeografi

Tiranë 2020

1. Kufiri jugor i Evropës është: **1 pikë**

- A) oqeani Atlantik;
- B) deti Mesdhe;**
- C) malet Urale;
- D) deti Kaspik.

2. Në cilat gjerësi gjeografike shtrihet pjesa më e madhe e Evropës? **1 pikë**

- A) Në gjerësitë polare të Hemisferës Veriore.
- B) Në gjerësitë mesatare të Hemisferës Veriore.**
- C) Në gjerësitë mesatare të Hemisferës Jugore.
- D) Në gjerësitë tropikale të Hemisferës Jugore.

3. Gadishulli i Jutlandës bën pjesë në rajonin e: **1 pikë**

- A) Evropës Perëndimore;
- B) Evropës Lindore;
- C) Evropës Veriore;**
- D) Evropës Jugore.

4. Në cilin nga rajonet e Evropës bën pjesë ishulli i Korsikës? **1 pikë**

- A) Në Evropën Perëndimore.
- B) Në Evropën Ishullore.
- C) Në Evropën Lindore.
- D) Në Evropën Jugore.**

5. Rajoni i Evropës Veriore dallohet për: **1 pikë**

- A) fjarde, liqene akullnajore dhe pyje të shumta.**
- B) relief fushor, liqene tektonike dhe pasuri minerale të arit;
- C) klimë alpine, vijë bregdetare pak të thyer dhe liqene antropogjenë;
- D) hidrografi të varfër, pyje të pakta, dhe mbizotërim të bimësisë së makjeve;

6. Lumi më i gjatë i rajonit të Evropës Lindore është. **1 pikë**

- A) Doni;
- B) Vollga;**
- C) Dniepri;
- D) Dvina Veriore.

7. Pjesën më të madhe të popullsisë në Amerikën e Veriut e përbën popullsia me origjinë: **1 pikë**

- A) aziatike;
- B) afrikane;
- C) indigjene.
- D) evropiane;**


8. Në cilin nga rajonet e mëposhtme bie sasia më e madhe e reshjeve në botë (rreth 12 000 mm reshje/vit)? **1 pikë**

- A) Në rajonin e Azisë Jugore.**
- B) Në rajonin e Azisë Juglindore.
- C) Në rajonin e Amerikës së Veriut.
- D) Në rajonin e Amerikës së Jugut.

9. Janë male të vjetra në Amerikën e Veriut dhe që dallohen për pasuri të shumta minerale: **1 pikë**

- A) Malet Shkëmbore;
- B) Malet Apalashë;**
- C) Malet Kordiliere;
- D) Malet e Andeve.

10. Në hartën e mëposhtme, pjesa me ngjyrën më të errët, paraqet rajonin e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore.



Territori i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore studiohet si rajon më vete, pasi vendet që gjenden në këtë rajon: **1 pikë**

- A) kanë të njëjtën pozitë gjeografike, shtrihen në brigjet e Mesdheut;
- B) ngjasojnë nga pikëpamja gjeografike, kulturore dhe fetare;**
- C) flasin të njëjtën gjuhë dhe praktikojnë besimin islam;
- D) kanë pasuri të shumta nafte dhe gazi natyror.

11. Deti i Vdekur, që shtrihet në Azinë Jugperëndimore, emërtohet kështu për shkak të: **1 pikë**

- A) thellësisë së madhe dhe mungesës së dritës;
- B) pranisë së madhe të organizmave të vdekur;
- C) ekzistencës së algave helmuese;
- D) sasisë së madhe të kripës.**

12. Më poshtë është paraqitur harta fiziko-gjeografike e rajonit të Amerikës së Jugut.



Pjesa e rrethuar me shkronjën A, përfaqëson: **1 pikë**

- A) ultësirën e Amazonës;
- B) shkretëtirën e Atakamës;
- C) rrafshnaltën e Guajanës;
- D) rrafshnaltën e Patagonisë.

13. Popullsia vendase e Amerikës Qendrore përbëhet nga: **1 pikë**

- A) metisët;
- B) negroidët;
- C) **indigjenët;**
- D) evropoidët.

14. Besimi fetar hinduist praktikohet më shumë nga popullsia e rajonit të: **1 pikë**

- A) Azisë Jugperëndimore.
- B) Azisë Juglindore.
- C) Azisë Lindore.
- D) **Azisë Jugore.**

15. Në cilin nga rajonet e mëposhtme gjenden pasuritë më të mëdha të diamantit dhe arit? **1 pikë**

- A) Në rajonin e Azisë Lindore.
- B) Në rajonin e Evropës Veriore.
- C) Në rajonin e Amerikës së Veriut.
- D) **Në rajonin e Afrikës Nën-Sahariane.**

16. Një nga tigrat ekonomike të rajonit të Azisë Juglindore është: **1 pikë**

- A) Timori Lindor
- B) Mianmari
- C) **Malajzia;**
- D) Laosi;


17. Në cilin rajon bëjnë pjesë shtetet e treguara në hartë? **1 pikë**



- A) Në Azinë Veriore.
- B) Në Azinë Lindore.
- C) Në Azinë Juglindore.
- D) Në Azinë Verilindore.

18. Figura e mëposhtme tregon rrotullimin e Tokës rreth boshtit. Në ç'drejtim rrotullohet Toka rreth boshtit të vet? **1 pikë**

- A) Nga veriu në jug.
- B) Nga lindja në perëndim.
- C) **Nga perëndimi në lindje.**
- D) Nga juglindja në jugperëndim.



19. Dita është e barabartë me natën në të gjitha pikat në Tokë, në datën: **1 pikë**

- A) **21 mars;**
- B) 22 qershor;
- C) 30 shtator;
- D) 22 dhjetor.


20. Një nga pasojat e qarkullimit të Tokës rreth Diellit është: **1 pikë**

- A) shmangia e trupave që lëvizin horizontalisht;
- B) formimi i ditës dhe natës;
- C) ndryshimi i kohës lokale;
- D) **formimi i stinëve.**

21. Në elementet gjeografike të hartës bën pjesë: **1 pikë**

- A) legjenda e hartës;
- B) shkalla e hartës;
- C) rrjeti hartografik;
- D) **hidrografia.**


22. Figura e mëposhtme paraqet një kodër nëpërmjet izohipseve.



Sa është lartësia maksimale e kodrës? **1 pikë**

- A) 25 metra.
- B) 30 metra.**
- C) 35 metra.
- D) 40 metra.

23. Vëzhgoni me kujdes hartën e mëposhtme. Cila nga pikat në hartë ka këto koordinata gjeografike: $\lambda 45^\circ$ në perëndim dhe $\phi 15^\circ$ në veri? **1 pikë**



- A) 1
- B) 3**
- C) 5
- D) 6

24. Reshjet orografike formohen si rrjedhojë e: **1 pikë**

- A) ngritjes së detyruar të ajrit nëpër shpatet apo pengesat malore;**
- B) takimit të masave ajrore me veti fizike të ndryshme në zonat fushore;
- C) zhvendosjes së masave ajrore në brigjet e ulëta detare;
- D) karakterit zbritës të masave ajrore në rrafshnalta.

25. Cila është shtresa e atmosferës ku bëhet e mundur formimi i reve? **1 pikë**

- A) Ekzosfera.
- B) Jonosfera.
- C) Troposfera.**
- D) Stratosfera.

26. Cili është shkaku i formimit të erërave? **1 pikë**

- A) Ndryshimi i trysnisë atmosferike në drejtim horizontal nga një vend në tjetrin.**
- B) Ndryshimi i sasisë së reshjeve në drejtim horizontal nga një vend në tjetrin.
- C) Ndryshimi i klimës në drejtim vertikal nga një vend në tjetrin.
- D) Ndryshimi i motit në drejtim vertikal nga një vend në tjetrin.

27. Liqenet më të thellë në botë janë me origjinë: **1 pikë**

- A) Karstike;
- B) Tektonike;**
- C) Vullkanike;
- D) Akullnajore.

28. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon në formimin e rrymave oqeanike? **1 pikë**


- A) Konfigurimi i brigjeve të kontinenteve në raport me oqeanet.
- B) Rritja e sasisë së avullimit nga sipërfaqja e oqeanëve.
- C) Erërat e qarkullimit të përgjithshëm.**
- D) Forca e Koriolisit.

29. Lartësia e baticave dhe zbatave ndryshon në varësi të: **1 pikë**

- A) vendndodhjes së Tokës ndaj Marsit.
- B) vendndodhjes së Hënës ndaj Tokës;**
- C) vendndodhjes së Hënës ndaj satelitëve;
- D) vendndodhjes së Tokës ndaj satelitëve artificialë;

30. Baza e valës në figurën e mëposhtme tregohet nëpërmjet numrit: **1 pikë**

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



31. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë në lidhje me pllakat tektonike? **1 pikë**

- A) Janë aq pllaka tektonike sa janë dhe kontinente.
- B) Janë më shumë pllaka tektonike sesa kontinente.**
- C) Kufiri i pllakave tektonike përputhet me atë të kontinenteve.
- D) Të gjitha pllakat tektonike janë më të mëdha se kontinentet.

32. Kur përplasen dy pllaka kontinentale me njëra tjetrën, formohen: **1 pikë**

- A) kreshtat mesoqeanike;
- B) gropat oqeanike;
- C) vullkanet;
- D) malet.**

33. Për cilën shtresë të Tokës janë karakteristike rrymat e konveksionit? **1 pikë**

- A) Bërthamën e brendshme.
- B) Bërthamën e jashtme.
- C) Mantelin.**
- D) Koren e tokës.

34. Veprimtaria gjërryese e lumenjve quhet: **1 pikë**

- A) erozion;**
- B) abrazion;
- C) korazion;
- D) deflacion.

35. Në cilin brez gjenden rreth 80% e vullkaneve veprues? **1 pikë**

- A) Në brezin e Oqeanit Paqësor.**
- B) Në brezin e Oqeanit Atlantik.
- C) Në brezin e Oqeanit Indian.
- D) Në brezin e Mesdheut.

Për t'ju përgjigjur pyetjeve 36 dhe 37 referojuni pasazhit të mëposhtëm.

Në datën 21 shtator 2019, në Shqipëri ra një tërmet me epiqendër në detin Adriatik, pranë Durrësit. Magnituda e tërmetit ishte 5.8 e shkallës Rihter, ndërsa intensiteti 7.5 ballë në Durrës dhe 4.5 ballë në Vlorë.

36. Në pasazhin e mësipërm shkruhet: "Magnituda e tërmetit ishte 5.8 e shkallës Rihter, ndërsa intensiteti 7.5 ballë në Durrës dhe 4.5 ballë në Vlorë.

Cili është ndryshimi midis magnitudës dhe intensitetit të tërmetit? **1 pikë**

- A) Magnituda tregon vendin në thellësi të tokës ku ndodh tërmeti, ndërsa intensiteti vendin në sipërfaqen e tokës.
- B) Magnituda tregon efektet e tërmetit në shkëmbinjtë magmatikë, ndërsa intensiteti në shkëmbinjtë sedimentarë.
- C) Magnituda tregon forcën ose energjinë e tërmetit në vatër, ndërsa intensiteti efektet sipërfaqësore të tij.**
- D) Magnituda tregon efektet sipërfaqësore të tërmetit, ndërsa intensiteti forcën ose energjinë e tij në vatër.

37. Në pasazhin e mësipërm shkruhet: "... ndërsa intensiteti 7.5 ballë në Durrës dhe 4.5 ballë në Vlorë.

Pse intensiteti i tërmetit ishte më i lartë (7.5 ballë) në Durrës, ndërsa në Vlorë më i ulët (4.5 ballë)? **1 pikë**

- A) Durrësi është më afër epiqendrës së tërmetit, ndërsa Vlora më larg.**
- B) Durrësi është zonë që përfshihet nga lëvizjet tektonike, ndërsa Vlora nuk përfshihet.
- C) Trualli i Durrësit është i ndërtuar nga shkëmbinjtë terrigjenë, ndërsa Vlora nga shkëmbinjtë magmatikë.
- D) Zona e Durrësit dallohet për thyerjet e shumta tektonike, ndërsa Vlora ka më pak thyerje tektonike.

38. Cunamet ndodhin si pasojë e lëvizjeve: **1 pikë**

- A) epirogjenike;
- B) eustatike;
- C) luhatëse;
- D) sizmike.**

39. Një nga faktorët që ndikon në zhvillimin e rrëshqitjeve të tokës është: **1 pikë**

- A) zhdukja e burimeve ujore;
- B) çarjet në muret e ndërtesave;
- C) prania e ujërave nëntokësore;**
- D) përkulja e drurëve të pemëve.

40. Zonaliteti vertikal është dukuri karakteristike, për: **1 pikë**

- A) peizazhet malore;
- B) peizazhet fushore;
- C) peizazhet bregdetare;
- D) peizazhet shkretinore.

41. Republika e Shqipërisë shtrihet në pjesën: **1 pikë**

- A) veriore të Ballkanit;
- B) lindore të Ballkanit;
- C) qendrore të Ballkanit;
- D) perëndimore të Ballkanit.

42. Pasuritë më të mëdha të naftës dhe gazit natyror në vendin tonë gjenden në: **1 pikë**

- A) Rajonin Verior-Verilindor;
- B) **Rajonin Perëndimor;**
- C) Rajonin Juglindor;
- D) Rajonin Jugor.

43. Është veçori e klimës së Shqipërisë: **1 pikë**

- A) ngrohja e klimës nga perëndimi në lindje;
- B) **ftohja e klimës nga perëndimi në lindje;**
- C) regjimi i rregullt i temperaturës;
- D) regjimi i rregullt i reshjeve.

44. Në sa qarqe ndahet Republika e Shqipërisë? **1 pikë**

- A) 12
- B) 36
- C) 46
- D) 61


45. Cila është dega e ekonomisë që ka marrë hov në Shqipëri pas vitit 1990? **1 pikë**

- A) Industria
- B) Peshkimi.
- C) Energjetika.
- D) **Shërbimet.**

46. Pllaja e Dumre-Darsisë është pjesë përbërëse e: **1 pikë**

- A) Rajonit Verior – Verilindor;
- B) **Rajonit Perëndimor;**
- C) Rajonit Juglindor;
- D) Rajonit Jugor.

47. Grafiku tregon ndarjen e popullsisë së Shqipërisë, sipas grupmoshave për vitin 2020.



Cila është grupmosha me përqindjen më të lartë? **1 pikë**

- A) Grupmosha në moshën e pensionit.
- B) Grupmosha nën moshën e punës.
- C) **Grupmosha në moshën e punës.**
- D) Grupmosha në moshën e tretë.

48. Në vitet 1945-1990, popullsia e Shqipërisë pati një rritje të ndjeshme, duke u trefishuar. Faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e popullsisë gjatë kësaj periudhe, ka qenë: **1 pikë**

- A) **shtimi i lartë natyror;**
- B) moslejimi i migracionit brenda vendit;
- C) izolimi i vendit dhe moslejimi i emigracionit;
- D) ulja e nivelit të vdekshmërisë në moshën e tretë.

49. Cili nga lumenjtë e mëposhtëm shërben si kufi jugor i Rajonit Verior – Verilindor? **1 pikë**

- A) Mati.
- B) Buna.
- C) Erzeni.
- D) **Shkumbini.**

50. Dallohen për drejtimin rrezor të kurrizeve malore dhe luginave lumore: **1 pikë**

- A) Malësia e Hasit dhe e Çermenikës;
- B) Vargjet e Skënderbeut;
- C) Malet Bregdetare
- D) **Alpet Shqiptare.**

51. Relievi i Rajonit Juglindor është formuar kryesisht nga një regjim tektonik në tërheqje. Për pasojë, në këtë rajon mbizotërojnë: **1 pikë**

- A) antiklinale-mbihipëse;
- B) antiklinale dhe sinklinale;
- C) **horstet dhe grabenet;**
- D) rrudhat e pjerrëta.

52. Pllaja Veleçik – Bridash ndërtohet kryesisht nga shkëmbinj gëlqerorë. Për pasojë ajo dallohet për: **1 pikë**

- A) rrjedhjen e pasur ujore sipërfaqësore;
- B) **praninë e proceseve të karstit;**
- C) pasuritë e shumta të kromit;
- D) bimësinë e dendur pyjore.

53. Cila nga karakteristikat e mëposhtme është e vërtetë për Luginën e Drinit të Zi? **1 pikë**

- A) Është formuar në një strukturë sinklinale.
- B) Ka drejtim kryesisht veriperëndim – juglindje.
- C) Shtrihet deri në lartësinë 200 m mbi nivelin e detit.
- D) **Dallohet për ndërthurjen e zgjerimeve dhe ngushtimeve.**

54. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për lumenjtë e Shqipërisë? **1 pikë**

- A) Kanë pjerrësi të vogël të pellgut ujëmbledhës.
- B) Përgjithësisht kanë një regjim të rregullt të rrjedhjes.
- C) Kanë shpejtësi të madhe në rrjedhën e poshtme të tyre.
- D) **Përgjithësisht burojnë nga lindja dhe derdhen në perëndim.**

55. Rajoni Juglindor dallohet për pasuritë minerale të: **1 pikë**

- A) **hekur – nikelit**
- B) gazit natyror
- C) naftës
- D) bitumit

56. Cila nga njësitë e mëposhtme fiziko-gjeografike përfaqëson një horst? **1 pikë**

- A) Lugina e Shkumbinit të Sipërm.
- B) Malësia e Dangëllisë.
- C) Fushëgropa e Korçës.
- D) **Mali i Thatë.**

57. Cila nga pjesët përbërëse të Rajonit Jugor është formuar në një strukturë sinklinale? **1 pikë**

- A) Fushëgropa e Delvinës.
- B) Malësia e Kurveleshit.
- C) **Lugina e Vjosës.**
- D) Mali i Çikës.

58. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për Rajonin Jugor? **1 pikë**

- A) Rajoni Jugor dallohet për një hidrografi të varfër sipërfaqësore.
- B) Rajoni Jugor dallohet për ndërtim gjeologjik të ndërlikuar.
- C) Në Rajonin Jugor mbizotëron bregdeti i tipit të ulët, me plazhe ranore.
- D) **Në Rajonin Jugor mbizotëron drejtimi veriperëndim-juglindje i formave të relievit.**

59. Cila nga pjesët përbërëse të Rajonit Juglindor që është formuar në një graben, ka lartësinë më të madhe mbi nivelin e detit? **1 pikë**

- A) Fushëgropa e Përrenjasit.
- B) Fushëgropa e Korçës.
- C) Gropa e Pogradecit.
- D) **Gropa e Kolonjës.**

60. Malësia e Çermenikës përbëhet nga formacione shkëmbore terrigjenë. Për pasojë, në këtë malësi mbizotëron më shumë: **1 pikë**

- A) relievi i lartë malor me majat e thepisura;
- B) **relievi i copëtuar dhe veprimtaria erozive;**
- C) procesi i karstit dhe liqenet e shumta karstike;
- D) relievi akullnajor me cirqe dhe lugina akullnajore